



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 23 Akti

Nr. 43 Vendimi

Tiranë, më 18.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli

Kryesuese

Olsi Komici

Relator

Roland Ilia

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në Tiranë, më datë 17 korrik 2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Nertina Kosova**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Nertina Kosova, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidate për anëtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Relatore e çështjes u zgjodh me short znj. Alma Faskaj. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 30.11.2017 me relatore znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur në datën 23.05.2018 u caktua si relator z. Olsi Komici, i cili deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

3. Me vendimin e datës 13.12.2017, trupi gjykues ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtarën Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me fillimin e procedurave të rivlerësimit, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD).

5. ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

¹ Raporti nr. 312/27 prot., datë 13.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit me nr. 84/2016.

1. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
2. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
4. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova.”*

7. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet janë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit, apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe një denoncim, nuk u gjetën indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cënojnë figurën e gjyqtarit.”

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 04.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Subjekti i rivlerësimit, më datë 04.07.2018 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e

²Me shkresën nr. 11803 prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. 2974/10 prot., datë 08.01.2017, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

dosjes më datë 05.07.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve dhe provave të reja më datë 09.07.2018.

11. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 13.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 17.07.2018, ora 11:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht. Znj. Kosova nuk paraqiti pretendime të reja shtesë, deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Nertina Kosova ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

Qëndrimi i saj dhe bashkëpunimi gjatë procesit të rivlerësimit janë marrë në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.

2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Në bazë të ligjit organik nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 24.01.2017, subjekti deklaron këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², ndodhur në adresën: Rr “***”, ap. ***, shk. ***, blloku ***, pas fabrikës “***”, pall. “***”, Tiranë. Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2006, në vlerën 6,000,000 lekë, *i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme*, i banueshëm në vitin 2008. Pjesa zotëruese 100 %.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”:

- *Kredi bankare në vlerën 5,000,000 lekë, sipas kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 17.12.2005. Diferenca në shumën e blerjes së apartamentit prej 1,000, 000 lekësh krijuar nga kursimet ndër vite.*

^[1] “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Hetimi i kryer nga Komisioni⁴:

Nga korrespondenca e mbajtur me ZVRPP-në Tiranë, kjo e fundit me shkresën e saj nr. 700/1 prot., datë 23.01.2018, nuk konfirmon ekzistencën e ndonjë pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Arsyetimi ligjor:

1.1 Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën e Interesave Private Periodik/Vjetor të vitit 2005 marrjen e kredisë për blerjen e saj.

1.2 Me kontratën e kredisë bankare (blerje shtëpie banimi ose rikonstruksion) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005, subjekti ka nënshkruar marrjen e kredisë në vlerën 5,000,000 lekë nga kredidhënësi “Raiffeisen Bank” sh.a. Në kontratë, në nenin 6 të saj është parashikuar sigurimi i kredisë nga dorëzanësit me anë të garancisë, hipotekimi i pasurisë së paluajtshme, sipas kontratës së hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005.

1.3 Në kartelën e së ZVRPP-së, në seksionin “E” të saj, konfirmohet se pasuria nr. *** , e ndodhur në lagjen “***”, Elbasan, regjistruar në ZK me nr. *** , me sipërfaqe totale 227.5 m², sipërfaqe ndërtese 101.5 m², volumi 26, faqe 1, në emër të babait të subjektit, z. Q. K., është hipotekuar në favor të kredidhënësit, bankës “Raiffeisen”, më datë 19.12.2005, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë nga subjekti i rivlerësimit.

1.4 Me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2006, subjekti ka nënshkruar porositjen e apartamentit në bllokun nr. 1, shkalla 2, ap. 1, kati i shtatë, me sipërfaqe ndërtimi 120 m², në vlerën 6,000,000 (gjashtë milionë) lekë. Në kontratë citohet se “...likuidimi u bë totalisht, kesh, në datën e nënshkrimit të saj, 04.09.2006”.

1.5 Sipas dokumentacionit bankar, disbursimi i kredisë është bërë më datë 27.12.2005. Sipas veprimeve bankare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën e marrë kredi në datë 04.01.2006.

1.6 Kontrata e sipërmarrjes për këtë pasuri është nënshkruar në shtator të vitit 2006. Në kontratë është pasqyruar se vlera e pasurisë është dhënë *cash* në datën e nënshkrimit të saj (kontratës) - më 04.09.2006.

1.7 Komisioni hetoi lidhur me arsyet e mbajtjes së vlerës së kredisë (5,000,000 lekë) jashtë sistemit bankar, prej janarit 2006 deri në nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, shtator 2006, për blerjen e kësaj pasurie.

Në lidhje me këtë konstatim⁵, subjekti ka deklaruar se: “Për shkak të statusit të saj “Gjyqtar pranë Gjykatës për Krime të Rënda”, qeveria shqiptare me një vendim të saj, “Mbi trajtimin dhe strehimin e funksionarëve të lartë të shtetit”, dhe marrëveshjes ndërmjet RBAL dhe

⁴ Referojuni shkresës nr. 101 prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZQRPP-së; shkresës së ZVRPP-së Tiranë nr.700/1 prot., datë 23.01.2018, sipas së cilës nuk konfirmohet ekzistenca e ndonjë pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të; shkresës së ZVRPP-së Elbasan nr. 119/1 prot., datë 12.01.2018.

Referojuni: shkresës nr. 4552 prot., datë 07.06.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank”; shkresës nr. 18658/1 prot., datë 12.06.2018 të “Raiffeisen Bank”, së cilës i është bashkëngjitur praktika e kredisë në emër të subjektit të rivlerësimit; shkresës nr. 316 prot., datë 11.01.2018, drejtuar OSHEE-së; shkresës nr. 757/1 prot., datë 30.01.2018, të OSHEE-së; shkresës nr. 1853 prot., datë 13.02.2018, drejtuar OSHEE-së për informacion lidhur me kontratë për furnizim të energjisë elektrike, specifikisht për periudhën 2005 - 2008; shkresës së OSHEE-së me nr. 2997/1 prot., datë 28.02.2018; shkresës me nr. 102 prot., datë 04.01.2018, drejtuar zyrës së ALUIZNI-t; shkresës së zyrës së ALUIZNI-t nr. 361/1 prot., datë 17.01.2018; shkresës nr. 1347 prot., datë 01.02.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe përgjigjes së saj nr. 1001/1 prot, datë 09.02.2018, sipas të cilës është informuar se subjekti i rivlerësimit, shtetasja Nertina Kosova, rezulton se më datë 27.05.2011 është ndarë nga trangu familjar i origjinës; përgjigjeve të pyetësorit, në datat 27.02.2018, 12.06.2018, 20.06.2018 të subjektit të rivlerësimit, etj.

⁵ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit 4, dërguar nga subjekti në datë 12.06.2018, administruar në dosje.

*Ministrisë së Financave, datë 20.06.2005, i ka akorduar kredi bankare për banesë, për të cilën ka nisur të interesohej për strehim në Tiranë. Pas këtij momenti deri në fund të muajit dhjetor është interesuar për gjetjen e apartamentit, derisa ka arritur të bëjë një marrëveshje me një subjekt ndërtimi. ... marrëveshja është konkretizuar rreth muajit nëntor - dhjetor. Banka me fondin limit të kredisë financonte deri në 70 % të çmimit të blerjes, dhe për këtë arsye çdo vlerë e apartamentit duhet të ishte mbi 6 milionë lekë, nga të cilat 30 % duhej t'i financonte ajo vetë dhe pjesa tjetër kredi bankare. Subjekti ka deklaruar se apartamenti ka pasur një vlerë mbi 6 milionë lekë dhe një pjesë të kësaj shume, mbi 1 milion, duhet ta financonte vetë. Pas tërheqjes së dokumentacionit në bankë, për kolateralin e vendosur (shtëpinë e prindërve në Elbasan) për llogari të kredisë së akorduar nga banka i është mundësuar lidhja e kontratës së kredisë bankare nr. 7513 rep., 2241 kol., datë 17.12.2005. Meqenëse pala tjetër është tërhequr prej kësaj marrëveshjeje për apartamentin, deklaroi se është gjendur sërish në rrethanat e kërkimit për një apartament banimi në Tiranë. Me prishjen e marrëveshjes është kthyer në gjendjen e mëparshme dhe shumën e mësipërme ua ka lënë sërish prindërve. Në këto rrethana, -ka deklaruar subjekti, -pasi isha në kushtet kur m'u kalua kredia në llogarinë time rrjedhëse, kam vazhduar të kërkoj nëpërmjet agjencive imobiliare e agjentëve të ndryshëm të shitjeve, për objekt "apartament" në zona dhe objekte të ndryshme të Tiranës. Për këtë arsye kam kontaktuar dhe negociuar me sipërmarrës, nënkontraktorë e furnitorë që kryenin klering për punimet e kryera në objektet e tyre, me qëllim për të dakordësuar çmimin më të mirë të mundshëm që më përshtatej. Gjatë kësaj periudhe kërkimi kam parë edhe negociuar objekte të cilat, ndonëse jam dakordësuar me çmimin, kanë pasur probleme me zbatimin e kushteve të lejes së ndërtimit dhe për këtë shkak nuk kam vendosur. Arsyet e përmendura më lart, -vijon subjekti, -justifikojnë edhe kohën ndërmjet lëvrimit të kredisë dhe lidhjes së kontratës së porosisë mbi këtë objekt/apartament, ku banoj aktualisht, në lagjen "***".*

1.8 Komisioni hetoi në lidhje me aftësinë paguese të subjektit për këtë pasuri, në shumën 1,000,000 lekë, krahas kredisë së përfitur.

Subjekti është pyetur⁶ dhe, ndër të tjera, ka deklaruar se: "Shuma 1,000,000 lekë është krijuar nga kursimet ndër vite, nga paga si pedagoge në vitet 1995- 1998, kurtime nga bursa në vlerën 4,480,000 lireta nga MAE (Itali/1999), paga si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan 1998 - 2004 dhe paga si gjyqtare në Gjykatën për Krime të Rënda Tiranë, 2004 -2006". Gjithashtu, në mbështetje të deklaramëve ka depozituar edhe dokumentacionin justifikues.

Subjekti ka deklaruar⁷ se: "Këtë shumë në blerjen e pasurisë ia kanë mbuluar prindërit nga pagat e kontribuara prej saj në familje ndër vite, nga 1995-a, të kursyer prej tyre dhe që e vunë në dispozicion, sepse kursimet e saj ndër vite janë mbajtur dhe administruar nga prindërit duke qenë një familje e përbashkët".

1.9 Subjekti është pyetur edhe lidhur me mosdeklarimin në vitin 2005, 2006, si dhe në Deklaratën-Vetting të kontributit të saj të mbajtur nga prindërit dhe që më pas ia kanë dhënë për blerjen e pasurisë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2006.

Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka deklaruar se: "Në lidhje me mosdeklarimin më parë të kontributit, kam konsideruar se meqenëse kanë qenë njëlloj kthimi i kontributit tim ndër vitet që kam jetuar pranë tyre dhe në themel ato kanë pasur si burim vetëm të ardhurat e mia nga pagat e bursa (1999), (nuk kam pasur të ardhura nga qira apo ndonjë aktivitet tjetër),

⁶ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit të datës 22.02.2018, dërguar nga subjekti më datë 27.02.2018, administruar në dosje.

⁷ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit 4, dërguar nga subjekti më datë 12.06.2018 dhe 20.06.2018, administruar në dosje.

prezumonte që deklarimi ishte i plotë, duke iu përmbajtur dhe titullimit të tabelës së deklarimit në atë vit. Në Deklaratën-Vetting kam thënë që burimi për blerje banese, përveç vlerës së kredisë, është nga kursimet e mia, sepse duke e konsideruar që shuma e dhënë/kthyer nga prindërit ka pasur në themel si burim kontributin nga të ardhurat e mia nga pagat, e kam gjykuar në këtë mënyrë si kursime nga pagat. Sikurse kam sqaruar edhe më parë, raporti i kontributit të kthyer nga prindërit dhe pagat e atij viti kanë qenë brenda asaj shume. Ndërmjet meje dhe prindërve nuk kemi gjykuar për të përpiluar ndonjë akt noterial”.

1.10 Komisioni, pasi kreu analizën financiare, referuar edhe përgjigjeve të pyetësorit⁸, konstatoi se në vitin 2006 subjekti gjendej në pamjaftueshmëri financiare për të justifikuar shumën 1,847,164 lekë. Në këto kushte, duke mbetur kryesisht në nivel deklarativ sa i përket provueshmërisë së kursimeve të krijuara prej kontributit të saj, por të mbajtura nga prindërit, nuk provohej aftësia paguese për këstin prej 1,000,000 lekësh për blerjen e apartamentit, si dhe për pjesën tjetër prej 847,164 lekësh, për të realizuar shpenzimet e tjera gjatë këtij viti.

1.11 Komisioni vlerësoi të kërkojë provueshmërinë shteruese me dokumentacion justifikues shtesë dhe më datë 04.07.2018, pasi mbylli hetimin kryesisht dhe vendosi dërgimin e rezultateve të hetimit subjektiv të rivlerësimit, për këtë konstatim, i dërgoi subjektivit edhe barrën e provës.

1.12 Subjekti më datë 9.07.2018 ka dërguar shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe njëkohësisht në mbështetje të tyre ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe dokumentacionin provues⁹.

Komisioni analizoi shpjegimet e subjektivit, si dhe dokumentet e mëposhtme:

- i. Vërtetim page të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr. ***, datë 28.10.2016;
- ii. Urdhër nr. 74, datë 26.06.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për gjyqtarët..., Nertina Kosova...;
- iii. Deklaratë, datë 5 korrik 2018, dhënë nga R. V. E., dhe A. E., në versionin anglisht dhe shqip;
- iv. Vërtetim nr. *** prot., datë 09.07.2018, nga “Raiffeisen Bank”, si dhe lëvizjet e llogarisë për këtë dispozitë bankare (tri fletë);
- v. Vërtetime të DRSSH-së Elbasan, të pagave dhe shpërblimeve të marra nga shtetasi Q. K., nr. *** prot., datë 18.10.2016;
- vi. Vërtetim i punëdhënësit, firma “***” Elbasan - 93, për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare për shtetasin Q. K.;
- vii. Vërtetime për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, fotokopje aktesh nr. *** prot., datë 06.07.2018, që i përkasin nënës së subjektivit të rivlerësimit, znj. B. K., për periudhën 01.01.1994 deri më datë 31.12.1997, 01.01.1998 deri më datë 31.12.2001, 01.01.2002 deri më datë 31.12.2005, 01.01.2006, 01.01.2010 deri më datë 13.02.2010, 01.01.1997 deri më datë 12.02.2010, 01.01.1997 (2001 - 2004), 2005 - 2008, 2009 - 2010;

⁸ Referojuni në dosje përgjigjeve të pyetësorit nr. 4 dërguar nga subjekti më datë 12.06.2018 (nr. 4667 prot.) dhe përgjigjeve të pyetësorit nr. 5 dërguar nga subjekti më datë 20.06.2018.

⁹ Referojuni materialit nr. 5153 prot., datë 09.07.2018, me lëndë: *Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ të rivlerësimit.*

- viii. Vërtetim i ISSH-së për punëdhënësin Policia e Ndërtimit Elbasan -37, për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, që i përket vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit K. K., për periudhën 27.11.2005 deri më datë 31.12.2007;
- ix. Vërtetim i Bashkisë Elbasan nr. 25/10 prot., datë 25.10.2016;
- x. Konfirmim bankar i bankës “Societe Generale Albania” nr. *** prot., datë 09.07.2018, së bashku me historikun e lëvizjeve nga 04.06.2006 deri më datë 16.10.2006;
- xi. Informacion mbi gjendjen e klientit Q. K., nga Banka e Shqipërisë, nr. ***;
- xii. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.07.2018, e deklaruesit Q. K., së bashku me kartë identiteti;
- xiii. Dy certifikata familjare të Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, datë 09.07.2018.

1.13 Nga dokumentacioni i depozituar, në vitin 2006 konfirmohet depozitë në emër të babait të subjektit, z. Q. K., në shumën 1,900,000 lekë, pranë bankës “Societe Generale Albania”, nga e cila rezulton të jetë kryer edhe një transaksion bankar në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes (04.09.2006), nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie. Konkretisht, në këtë datë, z. Kosova ka tërhequr shumën prej 600,000 lekësh. Depozita bankare dhe më tej edhe veprimet bankare për llogari të subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë marrëdhënien e posaçme familjare dhe kontributin e dhënë në blerjen e pasurisë. Veprimet bankare, vërtetimet e punësimeve të anëtarëve të familjes, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, deklarata noteriale e z. Kosova etj., vërtetojnë qartazi marrëdhënien e përbashkët familjare, mundësinë e krijimit të të ardhurave dhe njëkohësisht edhe administrimin e tyre nga babai i saj.

1.14 Në analizë të provave të reja dhe deklarimeve të subjektit, Komisioni kreu analizën financiare duke rilllogaritur të ardhurat e sakta të përfituara nga pagat e subjektit në vitin 2006, shpenzimet për mobilim në këtë vit, në shumën 20,000 lekë, shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe duke përfshirë edhe kursimet e realizuara nga kontributi i saj i administruar nga prindërit.

| | Përshkrimi | 2006 (ishte) | 2006 (bëhet) |
|----------|---------------------------------------|---------------------|---------------------|
| 1 | LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT | 5,199,405 | 5,199,405 |
| | Llogari pranë “Raiffeisen Bank” | 5,199,405 | 5,199,405 |
| 2 | PASURI | 6,000,000 | 6,000,000 |
| | Apartament | 6,000,000 | 6,000,000 |
| 3 | TË ARDHURA | 1,072,963 | 2,149,503 |
| | Të ardhura nga pagat e subjektit | 1,070,932 | 1,147,472 |
| | Interesa bankare | 2,031 | 2,031 |
| | Kursime të prindërve në vite | | 1,000,000 |
| 4 | SHPENZIME | 1,298,839 | 615,240 |
| | Shpenzime mobilimi | 600,000 | 20,000 |
| | Shpenzime principal dhe interesa | | |
| | kredie | 284,526 | 284,526 |
| | Shpenzime jetese | 160,714 | 160,714 |
| | Shpenzime qiraje | 120,000 | 120,000 |
| | Shpenzime udhëtimi TIMS | | |
| | pyetësor | 133,599 | 30,000 |
| 5 | LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT | 820,693 | 820,693 |

| | | | |
|--|---------------------------------|-------------------|----------------|
| | Llogari pranë “Raiffeisen Bank” | 151,735 | 151,735 |
| | Llogari pranë “Raiffeisen Bank” | 268,958 | 268,958 |
| | CASH | 400,000 | 400,000 |
| | DIFERENCA (1+3-2-4-5) | -1,847,164 | -87,025 |

Sipas analizës financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 1,000,000 (një milion) lekë si pjesë e investuar prej saj, në blerjen e kësaj pasurie.

✓ Trupi gjykues nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.

- Komisioni, nga hetimi i korrespondencës me institucionet bankare konstatoi kalimin e një shume prej 303.972 lekësh në llogarinë personale të subjektit më datë 13.11.2008. Komisioni hetoi lidhur me këtë fakt dhe konstatoi se transferta e kësaj shume ishte realizuar nga babai i subjektit, i cili këtë shumë e kishte tërhequr nga llogaria e përbashkët që ai kishte me subjektin e rivlerësimit. Në deklaratën e vitit 2008, Komisioni vërejtë se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë transfertë.

Subjekti është pyetur lidhur me deklaratimet e gjendjes bankare dhe ato *cash* në fund të çdo viti, përkatësisht prej vitit 2003 - 2016. Në pyetësin nr. 4, datë 12.06.2018, subjekti ka konfirmuar këtë shumë për vitin 2008, si shumë e rrjedhur nga mbyllja e depozitës dyemërore.

✓ Nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se nuk ka dyshime mbi këtë transfertë.

- Gjithashtu, Komisioni konstatoi nga korrespondenca me institucionet bankare kalimin e disa shumave monetare nga znj. E. S., për llogari të subjektit të rivlerësimit, respektivisht në vitet 2009 - 2013. U konstatua se transfertat janë relativisht në shuma të vogla, në periudha kohore të ndryshme dhe konkretisht të realizuara nga një person i afërt familjar (kunata e saj/nusja e vëllait). Tabela më poshtë pasqyron transfertat përkatëse.

| Datë valuta | Përshkrim i veprimit | Përfituesi | Urdhëruesi | Referenca e veprimit | Shuma Debi | Shuma Kredi |
|-------------|--|--------------------------------------|------------|----------------------|------------|-------------|
| 04.05.2009 | P0905041862OP14 TRANSFERTE | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P0905041862OP14 | 0 | 3000 |
| 26.05.2009 | 00039/EIN E. S. | | | TEIN00039 00N | 0 | 3000 |
| 04.11.2009 | P0911040167OP14 TRANSFERTE | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P0911040167OP14 | 0 | 2500 |
| 27.01.2011 | 00026/AGE E. D. | | | TAGE00026 00N | 0 | 2000 |
| 09.04.2012 | P1204090232OP14 KALIM NE LLOGARI | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P1204090232OP14 | 0 | 74000 |
| 02.05.2012 | P1205020616OP14 KALIM | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P1205020616OP14 | 0 | 60000 |
| 21.10.2013 | P1310213151OP14 KALIM NE LLOGARI | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P1310213151OP14 | 0 | 5600 |
| 12.11.2013 | P1311121349OP14 KALIM NE LLOGARI | NERTINA QAZIM KOSOVA (NOV 9 1972) | E. S. | P1311121349OP14 | 0 | 4000 |

✓ Nga hetimi i kryer rezulton se nuk ka dyshime mbi këto transferta.

2) Likuiditete në emër të subjektit, depozita bankare ose në llogari rrjedhëse, gjendje deri në 18 janar 2017, rezulton: Gjendja në llogarinë rrjedhëse të pagës, me nr. 0100406593, pranë “Raiffeisen Bank”, sipas printimit deri më datë 18 janar 2017 në vlerën **1,723,858 lekë**. Në këtë numër llogarie kanë kaluar ndër vite:

- kredia e disbursuar në vitin 2005,

- paga nga institucionet ndër vite,

- vlera e bonove të thesarit, me datë emetimi 31.03.2011, kanë kaluar nga “Raiffeisen Bank” me datë 29.03.2012,

- shpërblimet si eksperte nga “***”, si dhe limit overdrafti në shumën 75,000 lekë. Pjesa zotëruese 100 %.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

➤ Shkresë nr. 136 prot., datë 5.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.

“Raiffeisen Bank”¹⁰ ka konfirmuar këtë llogari në vlerën **1,723,858 lekë**.

✓ Nga verifikimi i dokumentit bankar konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij.

3) Vlera prej 100,000 lekësh, vijon pranë Fondit “***”, “Raiffeisen Bank”, nga data 08.10.2013 dhe interesi i patërhequr është në vlerën 22,019 lekë. Pjesa zotëruese 100 %.

Burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë:

- *Kursimet*

Hetimi i kryer nga Komisioni:

➤ Shkresë nr. 136 prot., datë 05.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.

“Raiffeisen Bank”¹¹ ka konfirmuar vlerën 100,000 lekë.

✓ Nga verifikimi i dokumentit bankar konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij.

4) Kartë krediti me nr. *** me të drejtë tërheqjeje limit në vlerën prej 1,400 eurosh, e deklaruar me afat deri më 05.01.2018.

¹⁰ Referojuni shkresës nr. 730/1 prot., datë 11.01.2018.

¹¹ Referojuni shkresës nr. 27 prot., datë 15.01.2018, të “Raiffeisen Invest”.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. 136 prot., datë 5.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.

“Raiffeisen Bank”¹² ka konfirmuar deklarimin.

- ✓ Nga verifikimi i dokumentit bankar, konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

5) Kursime personale, *cash*, aktualisht disponoj 1.250.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit:

- *Kursime nga paga; honorarë ndër vite të deklaruara. Pjesa zotëruese 100%.*

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me krijimin e pasurisë “likuiditet”.

- ✓ Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur mundësi ndër vite të mbledhë kursime, që kanë çuar në krijimin e pasurisë “likuiditet”, të deklaruar në Deklaratën-Vetting.

6) Kredi financiare, për blerje banese, pranë “Raiffeisen Bank”, me nr. *** rep., *** kol., datë 17.12.2005, në vlerën 5,000,000 lekë, disbursuar më datë 27.12.2005. Afati kohor i shlyerjes 25 vjet. Afati i mbylljes është më datë 27.12.2030. Interesi 3 %. Kësti mujor 23,710 lekë. Kolaterali i vendosur me kontratë hipotekore nr. 7514 rep., 2242 kol., datë 17.12.2005. Vlera e mbetur pa shlyer është 3,249,377.97 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. 136 prot., datë 5.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.
- Me shkresën nr. 730/1 prot., datë 11.01.2018 të “Raiffeisen Bank” vërtetohet disbursimi i kredisë prej 5,000,000 lekësh më datë 27.12.2005, ndërsa provohet vijueshmëria e shlyerjes së saj.

Nga hetimi, nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime dhe dyshime për këtë detyrim financiar.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ku ka konstatuar “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova”. Ky raport është deklasifikuar¹³ në datën 08.01.2018.

¹² Referojuni shkresës nr. 730/1 prot., datë 11.01.2018 të “Raiffeisen Bank”

¹³ Vendimi nr.8, datë 08.01.2018.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk u konstatua të ketë pasaktësi apo deklarime të rreme në plotësimin e formularit për kontrollin e figurës, sipas nenit 39 të ligjit 84/2016.

Për subjektin e rivlerësimit vlerësohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. 2974/10 prot., datë 08.01.2018.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke identifikuar rastet kur ajo normë ka natyrë të bardhë, kur plotësohet me ligje të veçanta specifike, referuar dosjeve nr. 1, 2 dhe 3, apo kur norma penale ka lidhje me akte ndërkombëtare, që janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar si pasojë e procesit të ratifikimit apo të aderimit, referuar dokumenteve 1 dhe 2, si dhe dosjes nr. 2 dhe 4. Gjithashtu, është konstatuar se ajo ka njohuri edhe nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës së Lartë, referuar dokumenteve nr. 1 dhe 2, si dhe dosjeve nr. 2, 3 dhe 4.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka njohuri sistematike të së drejtës penale për ato vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda. Bën lidhjen e duhur të pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale nuk është përfunduar dhe megjithatë autori ka përgjegjësi penale, si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit dhe dënimet alternative, referuar dosjeve nr. 3 dhe 5. Ajo njeh edhe legjislacionin e posaçëm për konfiskimin e pasurive me procedurë civile si masë parandaluese të krimit të organizuar, referuar dokumentit nr. 3. Gjithashtu, ajo zotëron edhe njohuri të rregullave procedurale të gjykimit të zakonshëm, të gjykimit të shkurtuar, apo të masave të sigurimit.

Në analizë të përbashkët të tri dokumenteve konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve. Organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

Ndër 5 dosjet e vëzhguara, 2 prej tyre nuk janë të ankimuara në gjykatat më të larta, konkretisht dosja nr. 3, që i përket vendimit nr. 81, datë 24.07. 2015, dhe nr. 5, që i përket vendimit nr. 113, datë 25.11.2015. Në një rast është konstatuar nga Gjykata e Lartë zbatimi i keq i ligjit material në kualifikimin e veprës penale, për shkak të së cilës vendimi i dhënë prej saj është cenuar, më konkretisht rasti i përket vendimit nr. 112, datë 23.11.2015 (dosja nr. 4). Në 2 rastet e tjera të ankimuara, gjykatat më të larta nuk kanë identifikuar mangësi në njohuritë ligjore të gjyqtarës znj. Nertina Kosova dhe konkretisht: në dosjen nr. 1, rekursi ndaj vendimit të saj nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë; ndërsa në dosjen nr. 2, vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Nertina Kosova, i është regjistruar për vlerësim profesional një raportim i kryetarit të gjykatës për vendimet e cenuara, i cili pasqyrohet më poshtë tek të dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së. Ky rast lidhet me vendimin gjyqësor nr. 69, datë 14.11.2012, të dhënë prej saj përpara periudhës së rivlerësimit kalimtar “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Nertina Kosova ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, por në 2 raste është konstatuar se analiza e provave ka qenë e tejzgjatur në paraqitjen e përmbajtjes shabllon të transkriptimit të përgjimeve, më konkretisht në dosjet nr. 1 dhe 5. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal, referuar tri dokumenteve, si dhe dosjeve nr. 1, 2, 3 dhe 4, apo kërkesat e legjislacionit të posaçëm, referuar dokumentin nr. 3.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga aktet ndërkombëtare, më konkretisht referuar dokumenteve 1 dhe 2, si dhe dosjeve nr. 2 dhe 4, apo jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, referuar dokumentit 1, që i përket vendimit nr. 69, datë 17.06.2015, dhe dokumentit 2, që i përket vendimit nr. 124, datë 14.12.2015, si dhe dosjeve nr. 2, 3 dhe 4.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, për ekzekutimin e vendimeve, por në vendimet e shkallës së dytë nuk tregohet e drejta e ankimit për palët, referuar dokumentit 1, që i përket vendimit nr. 69, datë 17.06.2015, dhe dokumentit 2 që i përket vendimit nr. 124, datë 14.12.2015, si dhe dosjes nr. 3 që i përket vendimit nr. 81, datë 24.07.2015, dosjes 4 që i përket vendimit nr. 122, datë 23.11.2015, dhe dosjes 5 që i përket vendimit nr.113, datë 25.11.2015.

Gjithashtu, te të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar saktë shkakun dhe bazën ligjore. Në një rast, gjyqtarja nuk ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës së parë gjyqësore, referuar dosjes 4 që i përket vendimit nr. 112, datë 23.11.2015, megjithatë ky fakt nuk ka shkaktuar dështimin e seancës, pasi palët janë njoftuar me shkresë nga kryetari gjykatës. Në një rast tjetër, vendimi i ndërmjetëm për shtyrjen e seancës nuk jep shkakun e caktimit të seancës pas disa ditëve, referuar dosjes 2, që i përket vendimit nr. 80, datë 03.07.2014

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, në periudhën e rivlerësimit ka kryer detyrën e gjyqtares në dy gjykata: konkretisht në periudhën 08.10.2013 - 30.07.2014 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndërsa në vijim deri në datën 08.10.2016 në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Ajo ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 322 çështje gjyqësore (219 çështje në shkallën e parë dhe 103 çështje në shkallën e dytë); ka përfunduar gjithsej 174 çështje gjyqësore (34 çështje penale themeli, 82 masa sigurimi, 42 kërkesa penale dhe 16 çështje gjyqësore me delegim në gjykatat e tjera të apelit), duke mbartur në vitin 2017 vetëm 1 çështje gjyqësore të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 54 %. Në nivelin e këtij rendimenti duket që ka ndikuar lëvizja e gjyqtares nga një gjykatë tek tjetra brenda periudhës së rivlerësimit.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtarja Nertina Kosova ka përfunduar gjithsej 66 çështje gjyqësore në shkallë të parë (61 penale dhe 5 civile antimafia) dhe 90 çështje gjyqësore në shkallë të dytë (88 penale dhe 2 civile antimafia).

Sipas pikës 3, shkronja “F”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 10 gjykime çështjesh penale në vit. Ndërsa sipas shkronjës “J” të së njëjtës pikë, gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 20 gjykime çështjesh penale në vit. Këto rregulla, në rastin e gjyqtares Nertina Kosova, nënkuptojnë një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 50 gjykime çështjesh penale për tre vjet.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Nertina Kosova ka qenë e shpejtë, në intervale kohore nga 8 ditë, referuar dosjen nr. 1 me objekt: “vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit G. D., për veprën penale të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal”, përfunduar me vendimin nr. 153, datë 24.09.2014, deri në 24 ditë referuar dosjes nr. 3. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 23 ditë, referuar dosjes nr. 2, 20 ditë, referuar dosjes nr. 4 dhe 16 ditë, referuar dosjes nr. 5. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati ligjor, apo ai standard i gjykimit, referuar dosjeve nr. 2, 3, 4 dhe 5, në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

Gjykimi i shpejtë dhe brenda afateve është konstatuar edhe te 3 dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është analizuar data e regjistrimit të çështjes në gjykatë në raport me datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Kështu, kohëzgjatja e gjykimit në këto 3 raste ka

qenë 3 muaj e 2 ditë, referuar dokumentit nr. 1, 1 muaj e 4 ditë, referuar dokumentit nr. 2 dhe 4 muaj e 12 ditë, referuar dokumentit nr. 3.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Nertina Kosova i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, ndonëse jo gjithmonë vendimet janë arsyetuar brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, vonesat kanë qenë disa ditore dhe justifikohen me natyrën komplekse të vendimeve të dhëna, si dhe nga fakti që në asnjë rast nuk është tejkaluar afati i ankimit në gjykatën më të lartë. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 6 ditëve nga arsyetimi, referuar dosjes nr. 1, që i përket vendimit nr.153, datë 24.09.2014; pas 5 ditëve, referuar dosjes nr. 2 që i përket vendimit nr.80, datë 3.07.2014); pas 7 ditëve referuar dosjes nr. 3, që i përket vendimit nr.81, datë 24.07.2015; pas 9 ditëve, referuar dosjes nr. 4, që i përket vendimit nr. 112, datë 23.11.2015 dhe pas 21 ditëve referuar dosjes nr. 5, që i përket vendimit nr.113, datë 25.11.2015.

Duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Nertina Kosova ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në të 5 çështjet gjyqësore, ajo ka marrë masat për planifikimin e seancës gjyqësore në kohën e duhur, duke respektuar edhe të drejtën e palëve për t'u përgatitur për gjykim. Në të 5 rastet është konstatuar respektimi i afatit ligjor në caktimin e seancës së parë. Po ashtu, në rastet kur gjykimi është zhvilluar me më shumë se 1 seancë, ka planifikuar seancën e radhës brenda afateve ligjore, referuar dosjes nr. 2 dhe 3. Në 1 rast, seanca gjyqësore nuk është planifikuar ditën e nesërme, referuar dosjes nr. 2, por gjithsesi gjykimi i çështjes ka përfunduar shumë shpejt – për 23 ditë.

Gjyqtarja Nertina Kosova ka kryer veprimet e nevojshme për seancën gjyqësore, duke identifikuar saktësisht palët pjesëmarrëse për njoftimin në kohën e duhur të tyre. Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të mungesës së njoftimit apo për shkak të pa përgatitjes së palëve në gjykim. 3 prej dosjeve të vëzhguara janë përfunduar me 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, referuar dosjeve nr. 1, 4 dhe 5. Dy çështje të tjera janë përfunduar me 2 seanca, referuar dosjeve nr. 2 dhe 3, ku vetëm 1 seancë ka qenë joproduktive për shkak të mosparaqitjes pa shkaqe të arsyeshme të mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri, referuar dosjes nr. 3. Këto të dhëna tregojnë se nga 7 seanca gjyqësore të vëzhguara, vetëm 1 prej tyre ka qenë joproduktive. Seancat janë çelur në kohën e planifikuar, me përjashtim të 1 rasti, ku seanca është çelur me 47 minuta vonesë për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarës Nertina Kosova dhe të një gjyqtari tjetër të trupit gjykues në një seancë tjetër gjyqësore, referuar dosjes nr. 3.

Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar gjer tek shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në dosje janë përfshirë rregullisht vendimi për caktimin e seancës gjyqësore (me përjashtim të dosjes nr. 4, ku ky vendim mungon), aktet e

njoftimit, procesverbali i seancës gjyqësore, kërkesat me shkrim të palëve dhe provat eventuale të paraqitura prej tyre, si dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale dhe është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore në çdo fletë dhe nga gjyqtarja në fund të tij. Në procesverbal dokumentohet saktësisht ora e fillimit të seancës, që konstatohet lehtësisht edhe me dokumentimin e vonesës nga 3 - 11 minuta, ndërsa në 1 seancë të filluar me 47 minuta vonesë, në procesverbal është dokumentuar edhe shkaku, referuar dosjes nr. 3. Gjithashtu, në procesverbal dokumentohet edhe ora e përfundimit të seancës, me përjashtim të 1 seance, ku kjo orë mungon, referuar dosjes nr. 3. Në çdo dosje të vëzhguar ndodhet 1 kopje e vendimit gjyqësor, hartuar me kompjuter, nënshkruar rregullisht nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Aktet në 5 dosjet e vëzhguara janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët. Fashikulli penal në të 5 dosjet e vëzhguara është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtarja Nertina Kosova është diplomuar “Jurist” në Universitetin e Tiranës, më datë 11.07.1995. Pas studimeve, më datë 30.05.1998, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në datën 20.02.2004, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimeve të Rënda Tiranë, ndërsa në datën 30.07.2014 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, ku ushtron detyrën edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Nertina Kosova. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore, të pakicave apo të së miturve, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj Nertina Kosova nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Nertina Kosova komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në rastin kur u drejtohet të tretëve me shkresa, komunikimi është i qartë dhe i sjellshëm. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo

elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtares dhe as kërkesa të vetë gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Nertina Kosova për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga 3 gjyqtarë, referuar dosjes nr. 1 dhe nga 5 gjyqtarë, referuar dosjeve nr. 2, 3, 4 dhe 5 dhe ka bashkëpunuar me ta dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas diplomimit "Jurist" në vitin 1998, z. Nertina Kosova në vitet 2009 - 2012 ka marrë titullin "Master i nivelit dytë shkencor", me profil *e drejta penale* nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Prej vitit 2014, ajo vazhdon studimet për doktoraturë pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë dhe të dytë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 15 seminare trajnimi, me temë "Trafikimi i qenieve njerëzore", më 27 - 28 mars 2014; "Etika gjyqësore", më 16 prill 2014; "Provat e marra në kundërshtim me ligjin. Pavlefshmëria e akteve procedurale. Jurisprudenca e GjL dhe GjEDNj", më 20 - 21 maj 2014; "Gjykimi i shkurtuar dhe çështje të zbatimit të tij, praktika gjyqësore dhe jurisprudenca kushtetuese", më 11 qershor 2014; "Standardet ndërkombëtare që lidhen me trajtimin e viktimave dhe parandalimin e riviktimizimit", më 3 dhjetor 2014; "Veprat penale që lidhen me korrupsionin", më 22 - 23 janar 2015; "Qasje në rastet e trafikimit në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë", (*trajnim trajnerësh*), më 25-30 janar 2015; "Të rejat që ka sjellë ligji i ri për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal", më 9 shkurt 2015; "Veprat penale kompjuterike. Mashtrimi kompjuterik në sistemin bankar, në siguracione, subvencione dhe kredi", më 24 - 25 shkurt 2015; "Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në fushën penale", më 16 - 17 prill 2015; "Viktimat e trafikimit. Intervistimi i fëmijëve dhe minorenëve", më 11 - 12 maj 2015; "Roli i gjyqtarit kombëtar në bashkëpunim me organizmat evropianë në çështjet penale", më 25 - 26 qershor 2015; "Hetimi i krimit financiar në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore", më 8-9 tetor 2015; "Dëgjimi i viktimave dhe grupeve vulnerable, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore", më 9-10 shkurt 2016; dhe "Hetimi i krimit financiar dhe nxjerrja e pasurisë kriminale", më 28-29 qershor 2016. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 29 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares për krime të rënda.

❖ **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale të gjyqtares Nertina Kosova rezulton se ajo është diplomuar "Jurist" nga Universiteti Tiranës në datën 11.07.1995. Pas studimeve, në datën 30.05.1998 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në datën 20.02.2004 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimeve të Rënda Tiranë, ndërsa në datën 30.07.2014 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e

Rënda Tiranë. Nuk konstatohet mospërputhje me të dhënat e deklaruara në Formularin e Vetëvlerësimit.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Nertina Kosova nuk janë paraqitur ankesa, por është verifikuar një raportim periodik i vitit 2014 i Kryetarit të Gjykatës për vendimet e cenuara. Nga verifikimi është konstatuar se vendimi gjyqësor nr. 69, datë 14.11.2012, i dhënë nga gjyqtarja Nertina Kosova është cenuar nga gjykatat më të larta dhe i është regjistruar asaj për vlerësim profesional dhe etik. Këto të dhëna tregojnë se veprimtaria gjyqësore e verifikuar e saj nga Inspektorati është në vitin 2012, pra përpara periudhës së rivlerësimit kalimtar “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Nertina Kosova përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Komisioni ka mbajtur korrespondencë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë¹⁴. KLD ka informuar se “Për gjyqtaren Nertina Kosova nuk rezulton të jetë marrë masë disiplinore apo të jetë propozuar marrja e një mase të tillë nga ana e Ministrisë të Drejtësisë.”

Në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, u mbajt në vëmendje dhe u analizua edhe 1 denoncim i bërë nga shtetasi F. H., (F. H.) pranë Komisionit.

Pas shqyrtimit të tij, nuk rezultuan prova apo fakte që kishin lidhje me këtë subjekt, për pasojë nuk konstatohen indice apo elementë që mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e gjyqtarit.

Në analizë të Raportit të Vlerësimit të kryer nga KLD, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë të asaj shkalle sa të çënojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit.

Pas hetimit të raportit të Grupit të Punës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe denoncimeve nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e gjyqtares, znj. Nertina Kosova.

Për sa më sipër, komisioner Olsi Komici, në cilësinë e relatorit të çështjes, pasi hetoi raportin e KLD-së, nuk gjeti të dhëna apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e gjyqtarit dhe ka propozuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, të vlerësohet: “E aftë”.

V. KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.

¹⁴ Referojuni shkresës nr. 670 prot., datë 18.01.2018, të Komisionit dhe përgjigjes së dhënë me shkresën nr. 286/1 prot., datë 21.02.2018, të KLD-së.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 18.07.2018, ora 11:00.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesues

Olsi KOMICI
Relator

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ina Serjanaj